



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 253/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.07.2020, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-55363-2020, me objekt: “Loti II: “*Blerje pajisje – Aparatura per analiza Mikrobiologjike per barnat*”, me fond limit: 8.218.948 lekë pa TVSH, zhvilluar me date 04.05.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Ankimues: “Fedos” sh.p.k
Nj.A. nr.2, Rr. Manol Konomi, Nd.14, H.2, Ap.2, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
Rruga “Aleksandër Moisiu”, Nr.84, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01.04.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-55363-2020, me objekt: “Loti II: “*Blerje pajisje – Aparatura per analiza Mikrobiologjike per barnat*”, me fond limit: 8.218.948 lekë pa TVSH, zhvilluar me date 04.05.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

II.2. Në datën 26.05.2020 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar. Nga vlerësimi i bërë nga KVO-ja rezulton si më poshtë:

- “Fedos” sh.p.k 4.790.000 lekë, skualifikuar
- “Biometrk Albania” sh.p.k 5.357.000 lekë, kualifikuar
- “Montal” sh.p.k 5.860.000 lekë, kualifikuar
- “Krijon” sh.p.k 6.165.000 lekë, kualifikuar
- “ECCAT” sh.p.k 6.645.000 lekë, skualifikuar
- “ALMedical” sh.p.k 7.370.000 lekë, skualifikuar
- “Pegasus” sh.p.k 8.155.000 lekë, skualifikuar

Operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k është skualifikuar nga KVO me argumentat e mëposhtme:

“Oferta juaj refuzohet për arsye se nuk keni përmbushur kriteret e përcaktuara në DST në lidhje me:

Arsye Nr.1: Në DST në pikën 2.3 “Për kapacitetin teknik” ku është kërkuar: “2.3.6) Operatori ekonomik duhet te paraqese fotokopje të deklarate së konformitetit, lëshuar nga prodhuesi me të dhënat specifike, bazuar në klasifikimin e pajisjes dhe /ose CE.”

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur/nuk ka dorëzuar dokumentacionin si vijon: 1) Fotokopje të deklaratës së konformitetit lëshuar nga prodhuesi më të dhënat specifike, bazuar në klasifikimin e pajisjes dhe /ose CE sipas pikës 2.3.6 të DST në lidhje me:- Artikulli Nr.4 “Aparat Steriliteti dhe Pompë vakumi” me prodhues “A-one Engg. Eorks”, me origjinë Indi, me Reference: “Sterility Test Unit Complete kit (Duck Clamp) + Vacuum Trap + AE45-S” të përshkruara në Deklaratën Teknike të datës 04.05.2020.

Arsye Nr.2: Në DST në Shtojcën 10 “Specifikime Teknike”, Loti II “Aparatura per analiza Mikrobiologjike per barnat” është kërkuar: Artikulli 1 “Testues steriliteti (ose ekuivalent) është kërkuar: “Materiali i bazës, rotor, portave lidhëse, mbajtësve, krahut shtrëngues: Çelik inoks 316 ose ekuivalent”.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresës me objekt “Kthim përgjigje kërkesës për sqarim” njoftuar nga OE në rrugë elektronike (SPE) më datë 19.05.2020, vlerësojmë se: Shpjegimet tuaja në lidhje me artikullin nr.1, konkretisht përbërja e materialit “Çelik inoks” të ofruar nga ju sipas të gjitha të dhënave në katalogun artikulli 1, faqe 3 ku shprehet “i lehtë për t’u pastruar”, e për rrjedhojë ekuivalent me “Çelik inoks 316”-; Nuk përmbush kërkesat teknike të përcaktuara në DST për funksionin që do të realizojë kjo pajisje për shkak se: - “referuar përbërjes kimike “Celik inoks 316” është celik me përbërje krom-nikel që përmban 2% - 3% molibden, dhe përmbajtja e këtij të fundit (Mo) rrit rezistencën ndaj korrozionit, veçanërisht në ambientet acide/alkaline, dhe qëndrueshmerinë në temperaturat e larta”.

II.3. Në datën 27.05.2020, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

“ [...]

Ne datën 04/05/2020 operoret ekonomike te interesuar kane dorezuar ofertat e tyre, dhe ne datën 26/05/2020, nepermjet sistemit te prokurimit elektronik, eëë.app.gov.al, jemi njohur me vendimarrjen e Autoritetit Kontraktor ku jemi njoftuar se, oferta e shoqerise tone, per Loti II: "Blerje pajisje-Aparatura per analiza Mikrobiologjike per barnat", eshte s'kualifikuar nga kjo procedure prokurimi me argumentin si me poshte:

"Oferta Juaj refuzohet per arsye se nuk keni permbushur kriteret e percaktuara ne DST ne lidhje me:

Arsye Nr.1: Në DST në pikën 2.3 “Për kapacitetin teknik” ku është kërkuar: “2.3.6) Operatori ekonomik duhet te paraqese fotokopje të deklarate së konformitetit, lëshuar nga prodhuesi me të dhënat specifike, bazuar në klasifikimin e pajisjes dhe /ose CE.”

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur/nuk ka dorëzuar dokumentacionin si vijon:1) Fotokopje të deklaratës së konformitetit lëshuar nga prodhuesi më të dhënat specifike, bazuar në klasifikimin e pajisjes dhe /ose CE sipas pikës 2.3.6 të DST në lidhje me:- Artikulli Nr.4 “Aparat Steriliteti dhe Pompë vakumi” me prodhues “A-one Engg. Ęorks”, me origjinë Indi, me Reference: “Sterility Test Unit Complete kit (Duck Clamp) + Vacuum Trap + AE45-S” të përshkruara në Deklaratën Teknike të datës 04.05.2020.

Lidhur me arsyen e dyte te skualifikimit: "Në DST në Shtojcën 10 "Specifikime Teknike", Loti II "Aparatura per analiza Mikrobiologjike per barnat" është kërkuar: Artikulli 1 "Testues steriliteti (ose ekuivalent) është kërkuar: "Materiali i bazës, rotorit, portave lidhëse, mbajtësve, krahut shtrëngues: Çelik inoks 316 ose ekuivalent". Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresës me objekt "Kthim përgjigje kërkesës për sqarim" njoftuar nga OE në rrugë elektronike (SPE) më datë 19.05.2020, vlerësojmë se: Shpjegimet tuaja në lidhje me artikullin nr.1, konkretisht përbërja e materialit "Çelik inoks" të ofruar nga ju sipas të gjitha të dhënave në katalogun artikulli 1, faqe 3 ku shprehet "i lehtë për t'u pastruar", e për rrjedhojë ekuivalent me "Çelik inoks 316"-; Nuk përmbush kërkesat teknike të përcaktuara në DST për funksionin që do të realizojë kjo pajisje për shkak se: - "referuar përbërjes kimike "Celik inoks 316" është celik me përbërje krom-nikel që përmban 2% - 3% molibden, dhe përmbajtja e këtij të fundit (Mo) rrit rezistencën ndaj korrozionit, veçanërisht në ambientet acide/alkaline, dhe qëndrueshmerinë në temperaturat e larta", theksojme se:

Ne DST, Shtojca 10 Specifikime Teknike, LOT II per artikullin 1, Testues steriliteti (ose ekuivalent), - Per analizat e sterilitetit ne sistem te mbyllur ka kerkuar: "Materiali i bazes, rotorit, portave lidhese, mbajtesve, krahut shtrengues: Celik inoks 316 ose ekuivalent"

Referuar ketij percaktimi nga ana jone eshte ofertuar produkti dhe eshte ngarkuar ne sistemin e prokurimit elektronik Katalog Nr.1.pdf. Ne karakteristikat e produktit eshte percaktuar 1. Me perberje celik inoksi i lehte per t'u pastruar.

Duke u bazuar ne kerkesen qe kishte AK per kete produkt sqarojme se shoqeria jone ka Ofertuar nje produkt i cili permbush 100% specifikimet Teknike.

Duke kerkuar nga ana AK nje produkt Celik inoksi 316 ose ekuivalent, cdo OE i lind e drejta te ofertoje nje produkt me perberje Celik Inoksi 316 ose ekuivalentin e tij. Nese AK eshte i interesuar te kete nje produkt vetem Celik inoks 316 atehere duhet te ishte kerkuar ne Specifikime Teknike dhe jo te vendosej termi "ose ekuivalent".

A ka ndonje material qe eshte me ekuivalent me Celik inoks 316 se vete Celik Inoksi qe ne kemi ofruar?!

Ne specifikime teknike te kerkuara, AK nuk ka kerkuar asnje lloj specifikimi te tipit:

Qendrueshmeri ne temperatura te larta apo rezistence ne ambiente acide/alkaline.

Vete Celik Inoksi 316 apo ekuivalentet e tij, nje nga te cilet eshte ofertuar dhe nga Shoqeria Fedos sh.p.k, kane ne perberje te tyre 2% - 3% Molibden, per rezistencen ndaj korrozionit. Qartesojme Autoritetin Kontraktor qe argumentimi i bere nga KVO qe "Celik inoks 316" eshte celik me perberje krom-nikel qe permban 2%-3% molibden, dhe permbajtja e ketij te fundit (MO) rrit rezistencen ndaj korrozionit, vecanerisht ne ambientet acide/alkaline, dhe qendrueshmerine ne temperature te larta", nuk qendron, pasi Celiku i Inoksit 316 ose ekuivalenti

i tij (Celik Inoksi), ne vetvete kane permbajtje identike te Molibden 2%-3% i cili rrit rezistencen ndaj korrozionit, Dhe duke gene se permban 2%-3% Molibden, ai gjithashtu siguron rezistence te shkelqyeshme per shumicen e faktoreve negative mjedisore, por as Celik inoksi 316 nuk ka lidhje me aciditetin apo qendrueshmerine ne temperatura te larta, ndaj KVO duhet se pari te kuptoje rolin qe kryen Molibden si perberes i Celikut te inoksit, te qartesohe qe Krom-nikel qe permban 2% - 3% Molibden eshte i rendesishem per nje mjedis qe perfshin nje sasi te larte elementesh gerryes, materiali do te vendoset nen uje ose do te ekspozohet ndaj ujit ne menyre te vazhdueshme.

Pra persa me lart, eshte qartesisht e dukshme qe KVO eshte e paqarte ne ate cfare ka argumentuar ne s'kualifikimin e saj, duke percaktuar vetem termin "i lehte per t'u pastruar" nderkohe qe katalogu konkretisht percakton: "Perberje celik inoks i lehte per tu pastruar".

KVO duke perdorur si arsye s'kualifikimi te dhena/argumenta te cilat jane absolutisht te pabazuara, pasi cdo dokument gjendet i ngarkuar dhe lehtesisht i vertetueshem, na krijon bindjen qe KVO po diskriminon shoqerine FEDOS duke e s'kualifikuar padrejtesisht dhe pse plotesojme cdo specifikim teknik te kerkuar. [...]Nderkohe qe ne rastin konkret KVO del jashte tagrit te tij, duke vendosur arsye skualifikimi dhe elemente te cilet nuk jane kerkuar ne specifikimet teknike te tipit: lidhje me aciditetin apo qendrueshmerine ne temperatura te larta, te cilat nuk kane asnje lloj lidhje me ate qe kerkohet. Ne si OE kemi paraqitur cdo dokumentacion qe permban te dhena dhe elemente qe jane gjykuar te nevojshem dhe te domosdoshem nga ana e autoritetit kontraktor. Referuar dhe dokumentave standarde te tenderit qe percakton se "Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria apo permbushja e specifikimeve teknike sipas dokumentave standarte te tenderit, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalogun/et e mallrave objekt prokurimi te perkthyer ne gjuhen shqipe, ku te verehen qarte karakteristikat teknike te mallit qe do te ofrohet me qellim qe autoriteti kontraktor te verifikoje permbushjen e specifikimeve teknike sipas percaktimeve ne dokumentat e tenderit ", theksojme se kataloget e paraqitur nga FEDOS sh.p.k., permbajne te gjitha te dhenat apo specifikimet teknike te produktit te kerkuar, sipas percaktimeve te bera nga autoriteti kontraktor ne shtojcen 10 "Specifikimet teknike", te dokumentave standarte te tenderit.[...]."

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 7606/146 prot., datë 02.06.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit si vijon:

"Me date 26.05.2020,ne Sistemin e Prokurimeve Publike (SPE) eshte bere njoftimi ne rruge elektronike i klasifikimit perfundimtar te ofertave te dorezuara per Latin II, ne lidhje me:

a) Kualifikimin e OE: 1."BIOMETRIK ALBANIA" sh.p.k.; 2."MONTAL" sh.p.k.; 3."KRIJON" sh.p.k.; dhe,

b) Skualifikimin e OE: 1."FEDOS" sh.p.k.; 2."ECCAT" sh.p.k.; 3."ALMedical" sh.p.k.; 4."PEGASUS" sh.p.k.; 5. "O.E.S DISTRIMED" sh.p.k.

Me date 27.05.2020, prane autoritetit kontraktor eshte depozituar ankesa e OE te skualifikuar "FEDOS" sh.p.k., me ane te se ciles kerkon: Ndryshimin e vendimit te Komisionit te Vleresimit te Ofertave dhe kualifikimin e OE "FEDOS" sh.p.k., per shkak se oferta e

dorezuar prej tij pervecse i ploteson specifikimet teknike, ka ofertuar dhe me cmimin me eficient per AK.

Konkretisht ankimuesi, ne menyre te permbledhur, pretendon se:

Se pari: Ne lidhje me arsyen e pare te skualifikimit "Mosplotesimin e kriterit te percaktuar ne piken 2.3.6 te DST-ve, Detyrimin per dorezimin e fotokopjes se Deklarates se Konformitetit, leshuar nga prodhuesi me te dhenat specifike, bazuar ne klasifikimin e pajisjes dhe/ose CE" - per Artikullin Nr.4 "Aparat Steriliteti dhe Pompe vakumi" me prodhues "A-one Engg. Ęorks" me origjine Indi, me Reference: "Sterility Test Unit Complete kit (Duck Clamp) + Vacuum Trap+ AE45-S" te pershkruara ne Deklaraten Teknike te dates 04.05.2020. "<- per te cilen pretendon se:

1) Ne SPE eshte ngarkuar Dokumenti me emertim AU_DOC_AONE.pdf, ne brendesi te te cilit ndodhet "Autorizimi i Prodhuesit" i cili i jep te drejten shoqerise "FEDOS"shpk te tregtoje artikujt brenda RSH, dhe ne faqen 6 te ketij dokumenti gjendet Certifikata CE e cila eshte sipas klasifikimit te pajisjes. Kjo certifikate eshte e te njejtit prodhues i cili eshte deklaruar edhe ne oferten teknike. Konkretisht ne certifikaten CE shprehet qartesisht qe Certifikata eshte ne perputhje me Direktiven 2014/68 per produktet "Pajisje laborator, produkte filtrimi dhe pajisje pastrimi" prodhuar nga kompania "A-one Engg. Ęorks". Prodhuesi ka te certifikuar me CE te gjitha produktet te cilat jane Pajisje Laboratori (konkretisht edhe produktin e kerkuar nga Autoriteti) pasi dhe vete objekti i prokurimit eshte "Blerje pajisje -Aparatura per analiza Mikrobiologjike".

2) Prodhuesi ka modele dhe kombinime te ndryshme dhe nuk mund te perfshije te gjitha modelet dhe kombinimet e ndryshme ne CE.

3) Certifikata CE tregon qe nje produkt eshte i certifikuar pasi jane kontrolluar te gjitha etapat qe ndikojne ne nxjerrjen e produktit final nga lenda e pare dhe te gjitha hallkat deri ne nxjerrjen e produktit. Trupi Certifikues "Regal Register (UK)" i ka leshuar kompanise prodhuese "A-one Engg. Ęorks", Certifikaten CE-2864 per pajisje laborator dhe produkte te tjera.

Se dyti: Ne lidhje me arsyen e dyte te skualifikimit "Mospermbushjen e kerkesave teknike te percaktuara ne Shtojcen 10 te DST e me konkretisht: "Shpjegimet tuaja ne lidhje me artikullin nr.1, konkretisht perberja e materialit "Celik inoks" te ofruar nga ju sipas te gjitha te dhenave ne katalogun artikulli 1, faqe 3 ku shprehet "i lehte per t'u pastruar", e per rrjedhoje ekuivalent me "Celik inoks 316"-; nuk permbush kerkesat teknike te percaktuara ne DST per funksionin qe do te realizoje kjo pajisje per shkak se: "referuar perberjes kimike "Celik inoks 316" eshte celik me perberje krom-nikel qe permban 2% - 3% molibden, dhe permbajtja e ketij te fundit (Mo) rrit rezistencen ndaj korrozionit, vecanerisht ne ambientet acide/alkaline, dhe qendrueshmerine ne temperaturat e larta" - per te cilen pretendon se:

Bazuar ne kerkesen qe kishte AK per kete produkt sqarojme se shoqeria "FEDOS"sh.p.k ka ofertuar nje produkt i cili permbush 100% specifikimet teknike. Duke kerkuar nga AK nje produkt "Celik inoks 316" ose ekuivalent, cdo OE i lind e drejta te ofroje nje produkt Celik inoks 316"

ose ekuivalent te tij. Nese AK eshte i interesuar te kete vetem nje produkt "Celik inoks 316" atehere duhet te ishte kerkuar ne Specifikime Teknike dhe jo te vendosej termi "ose ekuivalent".

Ne specifikimet teknike te kerkuara, AK nuk ka kerkuar asnje lloj specifikimi te tipit: qendrueshmeri ne temperatura te larta apo rezistence ne ambjente alkaline/acide.

Vete "Celik inoks 316" ose ekuivalentet e tij, nje nga te cilet eshte ofertuar nga shoqeria "FEDOS" sh.p.k., kane ne perberje te tyre 2%-3% molibden per rezistencen ndaj korrozionit.

"Celik inoks 316" nuk ka lidhje me aciditetin apo qendrueshmerine ne temperatura te larta, pasi roli i Molibden si perberes i "Celikut te inoksit" eshte i rendesishem per nje mjedis qe perfshin nje sasi te Iarte elernentesh gerryes, materiali do te vendoset nen uje ose do te ekspozohet ndaj ujit ne menyre te vazhdueshme.

Katalogu i dorezuar nga OE konkretisht percakton: "Perberje celik inoks i lehte per t'u pastruar", dhe jo vetem termin "i lehte per t'u pastruar" i shprehur ne arsyet e skualifikimit.

KVO ka vendosur arsye skualifikimi dhe element te cilet nuk jane kerkuar ne specifikimet teknike te tipit: ne lidhje me aciditetin apo qendrueshmerine ne temperatura te larta, te cilat nuk kane asnje lloj lidhje me ate qe kerkohet."

Autoriteti Kontraktor arsyeton se:

Te gjithë pretendimet e ngritura nga OE "FEDOS" sh.p.k., mbi bazen e te cileve kerkohet ndryshimi i vendimit te KVO-se dhe kualifikimi i ofertes se dorezuar nga ky OE, nuk jane te bazuar ne ligj dhe ne prova shkresore, pasi ne perfundim te shqyrtimit te dokumentacionit te dorezuar nga ky operator ekonomik ne sistem (SPE), dhe verifikimit te tyre ne perputhje me:

1) kriteret e percaktuara ne Dokumentat Standarde te Tenderit te hartuara per kete prokurim-Lot II- "Blerje pajisje-Aparatura per analiza Mikrobiologjike per barnat", me fond limit: 8.218.948 leke pa TVSH, me REF-55363-03-31-2020",-

2) dokumentacionin e mbajtur nga KVO per te gjithë procesin e shqyrtimit dhe vleresimit te ofertes se dorezuar nga OE;

Rezulton se: vleresimi i dokumentacionit ligjor, administrativ dhe teknik nga ana e Komisionit te Vleresimit te Ofertave per OE "FEDOS" sh.p.k. eshte ne perputhje me:

1) kriteret dhe kushtet e kerkuara ne DST e hartuara per kete prokurim,

2) legjislacionin ne fuqi per prokurimin publik.

Sa me lart, Autoriteti Kontraktor vendosi te mospranoje ankesen e paraqitur nga Operatori Ekonomik "FEDOS" sh.p.k."

II.6. Në datën 09.06.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.7. Në datën 18.06.2020 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 541/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 7606/157 prot., datë 16.06.2020, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Fedos” sh.p.k se: “Në DST në Shtojcën 10 ”Specifikime Teknike”, Loti II ”Aparatura per analiza Mikrobiologjike per barnat” është kërkuar: Artikulli 1 “Testues steriliteti (ose ekuivalent) është kërkuar: “Materiali i bazës, rotor, portave lidhëse, mbajtësve, krahut shtrëngues: Çelik inoks 316 ose ekuivalent”.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresës me objekt “Kthim përgjigje kërkesës për sqarim” njoftuar nga OE në rrugë elektronike (SPE) më datë 19.05.2020, vlerësojmë se: Shpjegimet tuaja në lidhje me artikullin nr.1, konkretisht përbërja e materialit “Çelik inoks” të ofruar nga ju sipas të gjitha të dhënave në katalogun artikulli 1, faqe 3 ku shprehet “i lehtë për t’u pastruar”, e për rrjedhojë ekuivalent me “Çelik inoks 316”-; Nuk përmbush kërkesat teknike të përcaktuara në DST për funksionin që do të realizojë kjo pajisje për shkak se: - “referuar përbërjes kimike “Celik inoks 316” është celik me përbërje krom-nikel që përmban 2% - 3% molibden, dhe përmbajtja e këtij të fundit (Mo) rrit rezistencën ndaj korrozionit, veçanërisht në ambientet acide/alkaline, dhe qëndrueshmerinë në temperaturat e larta”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.9 e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesave si më poshte vijon:

2.3.9) Operatori ekonomik duhet te paraqese per pajisjet objekt prokurimi nje deklarate, ne forme tabele, ku te plotesohet: Emertimi pajisjes, Emri i kompanise prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut te pajisjes, Nr. e faqes ku ndodhet pajisja, Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit. Pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te pajisjes qe ofertohet, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

III.1.2. Në shtojcën 10 “Specifikimet teknike” të dokumentave të tenderit rezulton se është kërkuar si vijon:

Loti II - Aparatura per analiza Mikrobiologjike per barnat

1. Testues steriliteti (ose ekuivalent), - Për analizat e sterilitetit në sistem të mbyllur

E përshtatshme për testimin e sterilitetit të produkteve farmaceutike që injektohen në trupin e njeriut nën lëkurë. Sistemi të ketë mundësi zgjedhje adaptorësh të tipeve të ndryshme në mënyrë që të testohen të gjithë tipet e kontenitorëve dhe paketimet e ndryshme farmaceutike.

Pompa të mos ketë nevojë për ventilim për të eliminuar lëshimin e grimcave ose mikrobeve, e pajisur me elemente sigurie.

Fluksi i pompës: 100 – 650 ml/min

Materiali i bazës, rotorit, portave lidhëse, mbajtësve, krahut shtrëngues: Çelik inoks 316 ose ekuivalent

Të ketë mundësi përdorimi me një pedal që shtypet me këmbë për të filluar punën

Konsumi i energjisë: jo me shume se 100 Ë- 150Ë

Sistemi të ketë mënyrë punë emergjence në rast shkëputje të energjisë

Bashkë me pajisjet të përfshihen të gjithë aksesorët e nevojshëm për vënien në punë te sistemit dhe bërjen e disa provave

Metoda e punës të jetë metoda e filtrimit 3me membrane ne nje sistem testimi te mbyllur

2. Inkubator (ose ekuivalent) - Inkubator $\pm 25^{\circ}\text{C}$ (ose ekuivalent) - Inkubimi i punës në respektim të farmakopesë

Diapazoni i temperatures: $+5^{\circ}\text{C}$ deri $+60$ - $+80^{\circ}\text{C}$

Saktësia e vendosjes së temperaturës: 0.1°C

Volumi i brendshëm: 30 litra – 40 litra

Pjesa e brendshme prej çeliku inoks

Me ftohje me element Peltier ose ekujvalent

Kontroller dixhital me ngjyra dhe mikroprocesor PID

Parametrat e rregullueshëm: temperatura, koha e programit

Programi ruhet në memorje në rast të ndërprerjes së energjisë

Sistem autodiagnostik

Alarm visual dhe akustik

Certifikim si pajisje mjekësore e klasit I në përputhje me direktivën 93/42/EEC ose ekuivalent.

3. Inkubator (ose ekuivalent), - Inkubator $\pm 37^{\circ}\text{C}$ - Inkubimi i punës në respektim të farmakopesë,

Diapazoni i temperaturës: $+10^{\circ}\text{C}$ mbi ambientin deri - $+80^{\circ}\text{C}$

Volumi i brendshëm: 50 litra - 60 litra

Pjesa e brendshme prej çeliku inoks

Me ventilim te rregullueshhem individualisht : Kontroller dixhital me ngjyra dhe mikroprocesor PID

Parametrat e rregullueshëm: temperaturë, pozicioni i valvulës së ajrit, koha e programit

Programi ruhet në memorje në rast të ndërprerjes së energjisë

Sistem autodiagnostik

Alarm visual dhe akustik

Certifikim si pajisje mjekësore e klasit I në përputhje me direktivën 93/42/EEC ose ekujvalent.

Monitor mbi temperaturen i klases se mbrojtjes 3.1

4. Aparat Steriliteti+Pompë vakumi (ose ekuivalent), - Zbulimin, izolimin, numërimin dhe identifikimin e mikroorganizmave (baktere, myqe, kërpudha).

Me 3 linja me vëllim 100 ml-120ml, të përbëra nga çelik inoks i gradës së lartë sipas standardeve.

Të kenë mundësi sterilizimi me autoklavim, me flakë, me tharje të nxehtë dhe metoda të tjera sipas ISO 8199 ose ekujvalente.

Me Erlenmeyer konik me vëllim 1000 ml- 2000 ml dhe tapë gome. Te mund te punoje me membrane ne diameter 47 ose 60. Me pompe vakumi me diafragëm, tërësisht pa vaj ose te integruar.

Shpejtësia e rrjedhjes: 25l/min -30 l/min

Presioni vakumit: 750mbar - 800mbar

Nivel zhurme: ≤ 50 db

Tensioni i punes: 220V/50Hz

Bashkë me pajisjet të përfshihen të gjithë aksesorët e nevojshëm për vënien në punë të sistemit dhe bërjen e disa provave

Sqarojmë se: presioni i kërkuar 750mbar është diferenca mes presionit që arrihet pas evakuimit dhe presionit atmosferik. E shprehur ndryshe do të thotë që pompa duhet të ketë kapacitet që të arrijë të paktën 750mbar më të ulët se presioni atmosferik.

5. Banjo mari (ose ekuivalent), - Për mbajtjen e medimeve në temperaturë e duhur për të vazhduar procesin e analizës

Kapacitet nga 14 Litra deri në 16 litra

Diapazoni i temperaturës të jetë nga 5 °C mbi temperaturën e ambientit deri në +95 °C

Të ketë kohëmatës dixhital të integruar

Të stakohet nxehja në rast të mbinxehjes si pasojë e një mosfunksionimi dhe në rastet kur temperatura kalon 10 °C mbi temperaturën e vendosur.

Banjo e ngrohjes të jetë rezistente ndaj korrozionit

Kontrollues me ekran dixhital që tregon temperaturën e vendosur dhe aktuale me saktësi 0.1 °C dhe kohën e mbetur nga programi.

6. Peshore analitike (ose ekuivalent) - Për peshimin e barnave(Pesha mesatare)

Kapaciteti i peshimit: nga 200g deri 300g

Sqarim: Kapaciteti i peshimit 220g nuk është i përjashtuar. Kapaciteti i peshimit 300 g eshte kufirii maksimal.

Lexueshmeria: 0.1mg

Riperseritshmeria: 0.1mg

Koha tipike e stabilizimit: ≤ 5

Diametri i pllakës së peshimit: jo më të vogël se 90mm ose sipërfaqe ekuivalente.

Porte USB

Mundësi lidhje me printer ose transferim direkt i të dhënave në kompjuter

7. Peshore teknike (ose ekuivalent) -Për peshimin e reagentëve për të përgatitur medimet dhe bufferat përkatës për analizë

Kapaciteti i peshimit nga 450 g deri 600g

Lexueshmeria: 10mg

Riperseritshmeria: 10mg

Lineariteti: 20mg

Koha tipike e stabilizimit: ≤ 5

Diametri i pllakes se peshimit: jo me i vogel se 180 mm , ose 140mm x 140 mm per pllake jo rrethore (ose sipërfaqe ekuivalente).

Të jetë konform standardeve EN 61010-1 dhe IEC 61326-1 ose ekuivalente

Sqarojmë: Janë përcaktuar kufijtë e kapacitetit të peshimit.

8. pH metter (ose ekuivalent), - Për rregullimin e pH të medimeve dhe bufferave që përgatiten.

Me 3 pika kontrolli

Kalibrimi me 3 pika pH dhe te beje njohjen automatike te tyre.

Të furnizohet me: sondën për matjen e pH, temperaturë; mbajtëse për sondën; ushqyesin e tensionet, solucionet e kalibrimit, kabëll për lidhje me kompjuter

9. Autoklavë vertikale (ose ekuivalent) - Për autoklavimin e materialeve sterilitet.

Dhoma e autoklavimit e ndërtuar prej inoksi të gradës 316Ti ose ekuivalent me rezistencë shumë të lartë ndaj korrozionit.

Vëllimi i dhomës së autoklavimit: nga 35 litra deri në 40 Litra

Monitorim i pavarur i temperaturës dhe presionit.

Sistem sigurie që ndalon hapjen e derës në rast se autoklava është nën presion.

Ciklet nuk fillojnë nëse dera është e hapur ose jo e mbyllur mirë.

Dera nuk hapet deri në çastin kur lëngjet arrijnë temperaturën e paracaktuar të përfundimit.

Dhoma e pajisur me valvul sigurie, e cila në rast të kalimit të limitit të presionit bën shkarkimin e tij.

Siguria e gjeneratorit të avullit: Sistem monitorimi për nivelin e ujit i cili të mbajë një nivel konstant uji për të siguruar punimin e sigurtë të ngrohësave. Sistem monitorimi për rrjedhjen e ujit.

Alarme: Alarme për dështimin e ciklit të autoklavimit dhe ndërprejeve.

Të plotesojë standartet:

Per presionin: PED 97/23 EEC, EN 10028-7, ASME Code Sec VIII ose ekuivalente

Sterilizimi: DIN 58951 Series, ISO 17665-1:2006 ose ekuivalente

Siguria: EC/UL/EN61010-1, IEC 61010-2- 040, EN 61326 ose ekuivalente

Sistemi i Cilesise: ISO 9001:2015, ISO 13485:2016 ose ekuivalente

Presioni të jetë me diapazon 0.6~2bar

Sqarojmë se: janë vendosur kufijte e vëllimit te dhomes se autoklavimit.

Sqarojmë se: specifikimi “Dera nuk hapet deri në castin kur lengjet arrijnë temperaturën e përcaktuar të përfundimit nënkupton që nga momenti i fillimit të ciklit deri sa autoklava arrin temperaturën e përfundimit dera nuk mund të hapet.

Sqarojmë se: pranohet standarti ndërkombëtar ISO , standarti Gjerman DIN si dhe ekuivalent i tyre. Pajisja domosdoshmërisht duhe të instalohet sipas standarteve ndërkombëtare dhe të ketë mundësi shërbimi të sistemeve të sigurisë sipas standarteve ndërkombetare.

Makine larëse enësh, profesionale (ose ekuivalent) - Për larjen dhe tharjen e enëve të laboratorit

Temp max. deri ne 95 °C. Permasat 800 -1000mm x 600-700mm x 600-850mm.

Sistemi i detyruar i tharjes se ajrit me filter HEPA

- Operatori ekonomik duhet te paraqese certificate CE dhe deklarate konformiteti per pajisjet e ofertuara, ne perputhje me klasifikimin e produktit.

- Në momentin e lidhjes se kontratës Pajisjet do te shoqerohen me Manualin e përdorimit në gjuhën Shqipe.

Termi “Ekuivalent” është përfshire në të gjitha specifikimet teknike per secilin aparat.

III.1.3. Në shtojcën 12 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit” të DT është parashikuar si vijon:

Loti II	Blerje pajisje – Aparatura per analiza Mikrobiologjike per barnat	Njësia	Sasia	Garancia
1	Testues steriliteti	copë	1	
2	Inkubator jo me pak se 30 lit	copë	2	
3	Inkubator jo me pak se 60 lit	copë	2	
4	Aparat Steriliteti +Pompë vakumi	copë	1	
5	Banjo mari	copë	1	
6	Peshore analitike deri ne 300gr per barna	copë	1	
7	Peshore analitike deri ne 600gr per reagentet	copë	1	
8	PH metter	copë	1	
9	Autoklavë vertikale	copë	1	
10	Makine larese profesionale per ene te mikrobiologjikut	copë	1	

Operatori ekonomik duhet te paraqese Deklarate garancie **jo më pak se 2 vjet**, per ato pajisje qe prodhuesi/distributori i autorizuar aplikon garanci.

Afatet e lëvrimit: 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës

III.1.4. Për plotësimin e kërkesës së autoritetit kontraktor lidhur me aparaturën “**Testues steriliteti** (ose ekuivalent), përsa i përket specifikimit teknik: “*Materiali i bazës, rotor, portave lidhëse, mbajtësve, krahut shtrëngues: Çelik inoks 316 ose ekuivalent*”, operatori ekonomik ankimues “Fedos” sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:

- Deklaratë mbi Përmbushjen e Specifikimeve Teknike
- Dokumentin “Deklarate” ne forme tabele, e plotësuar me emertimin e pajisjes, emrin e kompanise prodhuese, origjinën e mallit, emertimin e katalogut te pajisjes, nr. e faqes ku ndodhet pajisja, numrin e references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, për të gjitha produktet e ofruara.
- Katalogët e përkthyer për pajisjet përkatëse.

III.1.5. Në datën 19.05.2020, nëpërmjet SPE-së autoriteti kontraktor i ka kërkuar sqarime ankimuesit në lidhje me:

a) *Specifikimet teknike të aparaturave të kërkuara në DST me ato të ofruara në katalogët e dorëzuar për këtë qëllim si vijon:*

“*Testues steriliteti (ose ekuivalent) (Artikulli nr.1) është kërkuar për: “Materiali i bazës, rotor, portave lidhëse, mbajtësve, krahut shtrëngues: Çelik inoks 316 ose ekuivalent”. Në katalogun e dorëzuar nga ana juaj nuk është i shprehur ky specifikim*”

III.1.6. Operatori ekonomik "Fedos" sh.p.k, nëpërmjet shkresës me objekt: "Kthim përgjigje kërkesës për sqarim", datë 19.05.2020, i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, duke e sqaruar si vijon:

"Diten e sotme shoqeria Fedos shpk eshte njohur nepermjet SPE me shkresen me lende "Kërkesë për sqarim", lidhur me me prokurimin me objekt: Loti II "Blerje pajisje aparatura për analiza mikrobiologjike për barnat", me fond limity 8.218.948 lekë pa tvsh.

Në zbatim të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin public", i ndryshuar, neni 22, pika 1, neni 53, pika 1 si dhe VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", bashkëngjitur gjeni sqarimin sipas kërkesës suaj.

Referuar kërkesës suaj për sqarim për "Testues steriliteti (ose ekuivalent) (Artikulli nr.1) është kërkuar për: "Materiali i bazës, rotori, portave lidhëse, mbajtësve, krahut shtrëngues: Çelik inoks 316 ose ekuivalent". Në katalogun e dorëzuar nga ana juaj nuk është i shprehur ky specifikim", ju sqarojmë se:

- Në katalogun e ngarkuar në SPE i emërtuar Katalog Art.1, faqe 3 janë përcaktuar karakteristikat: 1.Me përbërje çelik inoks i lehtë për tu pastruar.
- Materiali i bazës, rotori, portave lidhëse, mbajtësve, krahut shtrëngues përbëjnë artikullin nr.1-Testues steriliteti me pompë dhe ky artikull është në tërësi me përbërje çelik inoksi.
- Përveç se është shkruar dhe e markuar me të verdhë dhe në foton që është e pasqyruar në katalog dallohet që materiali në tërësi i artikullit nr.1 është çelik inoksi."

III.1.7. Ndërsa përsa i përket arsyes së mësipërme të skualifikimit, operatori ekonomik ankimues pretendon se: Lidhur me arsyen e skualifikimit: "Në DST në Shtojcën 10 "Specifikime Teknike", Loti II "Aparatura per analiza Mikrobiologjike per barnat" është kërkuar: Artikulli I "Testues steriliteti (ose ekuivalent) është kërkuar: "Materiali i bazës, rotori, portave lidhëse, mbajtësve, krahut shtrëngues: Çelik inoks 316 ose ekuivalent". Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresës me objekt "Kthim përgjigje kërkesës për sqarim" njoftuar nga OE në rrugë elektronike (SPE) më datë 19.05.2020, vlerësojmë se: Shpjegimet tuaja në lidhje me artikullin nr.1, konkretisht përbërja e materialit "Çelik inoks" të ofruar nga ju sipas të gjitha të dhënave në katalogun artikulli 1, faqe 3 ku shprehet "i lehtë për t'u pastruar", e për rrjedhojë ekuivalent me "Çelik inoks 316"-; Nuk përmbush kërkesat teknike të përcaktuara në DST për funksionin që do të realizojë kjo pajisje për shkak se: - "referuar përbërjes kimike "Celik inoks 316" është celik me përbërje krom-nikel që përmban 2% - 3% molibden, dhe përmbajtja e këtij të fundit (Mo) rrit rezistencën ndaj korrozionit, veçanërisht në ambjentet acide/alkaline, dhe qëndrueshmerinë në temperaturat e larta", theksojmë se:

Ne DST, Shtojca 10 Specifikime Teknike, LOT II per artikullin 1, Testues steriliteti (ose ekuivalent), - Per analizat e sterilitetit ne sistem te mbyllur ka kerkuar: "Materiali i bazes, rotori, portave lidhese, mbajtesve, krahut shtrengues: Celik inoks 316 ose ekuivalent"

Referuar ketij percaktimi nga ana jone eshte ofertuar produkti dhe eshte ngarkuar ne sistemin e prokurimit elektronik Katalog Nr.1.pdf. Ne karakteristikat e produktit eshte percaktuar 1. Me perberje celik inoksi i lehte per t'u pastruar.

Duke u bazuar ne kerkesen qe kishte AK per kete produkt sqarojme se shoqeria jone ka Ofertuar nje produkt i cili permbush 100% specifikimet Teknike.

Duke kerkuar nga ana AK nje produkt Celik inoksi 316 ose ekuivalent, cdo OE i lind e drejta te ofertoje nje produkt me perberje Celik Inoksi 316 ose ekuivalentin e tij. Nese AK eshte i interesuar te kete nje produkt vetem Celik inoks 316 atehere duhet te ishte kerkuar ne Specifikime Teknike dhe jo te vendosej termi "ose ekuivalent".

A ka ndonje material qe eshte me ekuivalent me Celik inoks 316 se vete Celik Inoksi qe ne kemi ofruar?!

Ne specifikime teknike te kerkuara, AK nuk ka kerkuar asnje lloj specifikimi te tipit:

Qendrueshmeri ne temperatura te larta apo rezistence ne ambiente acide/alkaline.

Vete Celik Inoksi 316 apo ekuivalentet e tij, nje nga te cilet eshte ofertuar dhe nga Shoqeria Fedos sh.p.k, kane ne perberje te tyre 2% - 3% Molibden, per rezistencen ndaj korrozionit. Qartesojme Autoritetin Kontraktor qe argumentimi i bere nga KVO qe "Celik inoks 316" eshte celik me perberje krom-nikel qe permban 2%-3% molibden, dhe permbajtja e ketij te fundit (MO) rrit rezistencen ndaj korrozionit, vecanerisht ne ambjentet acide/alkaline, dhe qendrueshmerine ne temperature te larta", nuk qendron, pasi Celiku i Inoksit 316 ose ekuivalenti i tij (Celik Inoksi), ne vetvete kane permbajtje identike te Molibden 2%-3% i cili rrit rezistencen ndaj korrozionit, Dhe duke qene se permban 2%-3% Molibden, ai gjithashtu siguron rezistence te shkelqyeshme per shumicen e faktoreve negative mjedisore, por as Celik inoksi 316 nuk ka lidhje me aciditetin apo qendrueshmerine ne temperatura te larta, ndaj KVO duhet se pari te kuptoje rolin qe kryen Molibden si perberes i Celikut te inoksit, te qartesohet qe Krom-nikel qe permban 2% - 3% Molibden eshte i rendesishem per nje mjedis qe perfshin nje sasi te larte elementesh gerryes, materiali do te vendoset nen uje ose do te ekspozohet ndaj ujit ne menyre te vazhdueshme.

Pra persa me lart, eshte qartesisht e dukshme qe KVO eshte e paqarte ne ate cfare ka argumentuar ne s'kualifikimin e saj, duke percaktuar vetem termin "i lehte per t'u pastruar" nderkohe qe katalogu konkretisht percakton: "Perberje celik inoks i lehte per tu pastruar".

KVO duke perdorur si arsye s'kualifikimi te dhena/argumenta te cilat jane absolutisht te pabazuara, pasi cdo dokument gjendet i ngarkuar dhe lehtesisht i vertetueshem, na krijon bindjen qe KVO po diskriminon shoqerine FEDOS duke e s'kualifikuar padrejtesisht dhe pse plotesojme cdo specifikim teknik te kerkuar. [...]Nderkohe qe ne rastin konkret KVO del jashte tagrit te tij, duke vendosur arsye skualifikimi dhe elemente te cilet nuk jane kerkuar ne specifikimet teknike te tipit: lidhje me aciditetin apo qendrueshmerine ne temperatura te larta, te cilat nuk kane asnje lloj lidhje me ate qe kerkohet. Ne si OE kemi paraqitur cdo dokumentacion qe permban te dhena dhe elemente qe jane gjykuar te nevojshem dhe te domosdoshem nga ana e autoritetit kontraktor. Referuar dhe dokumentave standarde te tenderit qe percakton se "Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria apo permbushja e specifikimeve teknike sipas dokumentave standarte te tenderit, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalogun/et e mallrave objekt prokurimi te perkthyer ne gjuhen shqipe, ku te verehen qarte karakteristikat teknike te mallit qe do te ofrohet me qellim qe autoriteti kontraktor te verifikojte permbushjen e specifikimeve teknike sipas percaktimeve ne dokumentat

e tenderit ", theksojme se kataloget e paraqitur nga FEDOS sh.p.k., permbajne te gjitha te dhenat apo specifikimet teknike te produktit te kerkuar, sipas percaktimeve te bera nga autoriteti kontraktor ne shtojcen 10 "Specifikimet teknike", te dokumentave standarte te tenderit".

III.1.8. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese".

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, përcakohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... ."

III.1.9. Në nenin 27 "Kontratat e mallrave", pika 3, e VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar parashikohet se: "Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve".

Në pikën 6, po këtu, parashikohet se: "Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike;dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike."

III.1.10. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.11. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP vëren se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin *per pajisjet objekt prokurimi, nje deklarate, ne forme tabele, ku te plotesohet: Emertimi pajisjes, Emri i kompanise prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut te pajisjes, Nr. e faqes ku ndodhet pajisja, Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit dhe pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te pajisjes qe ofertohet*, në mënyrë që të provohet pajtueshmeria e tyre me specifikimet teknike. Gjithashtu, në shtojcën mbi specifikimet teknike të publikuara nga autoriteti kontraktor janë përcaktuar specifikimet teknike të cilat duhet të plotësojë aparati “*Testues steriliteti (ose ekuivalent)*”, ku ndër të tjera, është kërkuar: “*Materiali i bazës, rotor, portave lidhëse, mbajtësve, krahut shtrëngues: Çelik inoks 316 ose ekuivalent*”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, në përmbushje të kërkesës së mësipërme, rezulton se, operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, “Deklarate” ne forme tabele, në të cilin jepen informacion në lidhje me emertimin e pajisjes, emrin e kompanise prodhuese, origjinën e mallit, emertimin e katalogut te pajisjes, nr. e faqes ku ndodhet pajisja, numrin e references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, për të gjitha produktet e ofruara. Gjithashtu operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në sistem katalogë të përkthyer për për pajisjet përkatëse.

Nisur nga arsyeja e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor për operatorin ekonomik “Fedos” sh.p.k., si dhe pretendimet e këtij të fundit, në lidhje me aparatën “*Testues steriliteti (ose ekuivalent)*”, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, konkretisht, në katalogun e paraqitur për produktin e kërkuar, konstatohet se, përsa i përket kërkesës: *Materiali i bazës, rotor, portave lidhëse, mbajtësve, krahut shtrëngues: Çelik inoks 316 ose ekuivalent*, në katalogun e paraqitur nga ankimuesi kërkesa në fjalë, (sipas ankimuesit) është plotësuar nëpërmjet karakteristikave të produktit: “*perberje celik inoksi i lehte per t'u pastruar*”.

Lidhur me këtë fakt, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në dokumentat e tenderit është parashikuar një gradë e caktuar celiku dhe konkretisht 316, ose ekuivalent, ndërkohë që në katalogun e operatorit ekonomi ankimues nuk është paraqitur asnjë grade celiku, në mënyrë që Komisioni i Prokurimit Publik të arsyetojë nëse materiali celik inoks i paraqitur prej tij në ofertë është ekuivalent apo jo me treguesit që përmban celiku inoks 316, i parashikuar në specifikimet teknike të dokumentave të tenderit.

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se në dokumentat e tenderit *AK nuk ka kerkuar asnje lloj specifikimi te tipit: Qendrueshmeri ne temperatura te larta apo rezistence ne ambiente acide/alkaline*, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi lidhur me gradën 316 të celikut inoks, pra çfarë specifikimesh teknike përmban kjo gradë celiku, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor, deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave, parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që*

kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”. Në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.

III.1.12. Sa më sipër, KPP gjykon se, kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Fedos” sh.p.k. për skualifikimin e padrejtë të tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme qëndrojnë dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Fedos” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr.REF-55363-2020, me objekt: “Loti II: “*Blerje pajisje – Aparatura per analiza Mikrobiologjike per barnat*”, me fond limit: 8.218.948 lekë pa TVSH, zhvilluar me date 04.05.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 541 Protokolli

Datë 09.06.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri